VENDIM
Nr.37, datë 5.7.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË "VEPRIMIT PËR ANKANDET E KAPACITETIT TË INTERKONEKSIONIT", SI DHE "KONTRATA TIP PËR ALOKIMIN E KAPACITETIT INTERKONEKTUES TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË SHQIPËRISË NDËRMJET PALËS KONTRAKTUESE TË KAPACITETIT DHE OST SHA"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "j", nenit 9, nenit 31 pika 2, dhe 55, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike ", të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, të ndryshuar, neni 11 germa "A", neni 19, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 5.7.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e "Rregullores së veprimit për alokimin e kapacitetit të interkoneksionit", si dhe "Kontrata tip për alokimin e kapacitetit interkonektues të sistemit të transmetimit të Shqipërisë ndërmjet palës kontraktuese të kapacitetit dhe OST sh.a.

2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për zhvillimin e procesit deri në përfundim të tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta